

### Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në Kosovë ka vazhdua të rritet edhe në tremujorin e tretë (TM3) të vitit 2013. Në këtë kontekst, vlen të theksohet përmirësimi i bilancit tregtar. Ky përmirësim është ndikuar si nga rritja e eksporteve ashtu edhe nga rënia e importeve, gjë që mund të sugjeroj se një pjesë e importit mund të jetë zëvendësuar nga prodhimi vendor. Remitencat dhe investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje përkundër vështirësive me të cilat është duke u përballur eurozona. Sektori fiskal ka vazhduar zgjerimin e shpenzimeve duke vazhduar t'i kontribuojë pozitivisht rritjes ekonomike. Asetet e sektorit bankar kanë vazhduar të rriten. Rritjen më të madhe në kuadër të aseteve e kanë shënuar rezervat e mbajtura BQK, ndërkohë që kreditimi bankar, përkundër normës pozitive të rritjes, vazhdon të karakterizohet me ngadalësim të trendit të rritjes. Bazuar në Anketën e Kreditimit Bankar, shtrëngimi i kredidhënies në masë të madhe vlerësohet të jetë ndikuar nga shtrëngimi i standardeve dhe kriterëve për kreditimin e ndërmarrjeve. Në anën tjetër, të dhënat nga anketa e Odës Ekonomike të Kosovës me biznese tregojnë se bizneset kryesisht kanë raportuar për një situatë më të favorshme biznesore në TM3 2013 në krahasim me tremujorin paraprak.

Norma e inflacionit në Kosovë vazhdoi trendin rënës edhe gjatë TM3 2013, që është kryesisht në linjë me trendin e çmimeve të importit.

**Bilanci tregtar ka shënuar përmirësim** si rezultat i rritjes së eksportit dhe rënies së importit.

**Remitencat dhe investimet e huaja direkte** kanë shënuar rritje.

**Inflacioni** ka vazhduar trendin rënës. Norma mesatare vjetore e inflacionit në TM3 2013 ishte 1.2 përqind..

**Anketa për klimën e biznesit** tregon për zhvillime të favorshme në krahasim me tremujorin paraprak.

Tregu i bonove të thesarit vazhdoi të karakterizohet me ofertim të lartë dhe me normë të ulët të interesit që reflekton stabilitetin financiar dhe fiskal në Kosovë.

Për tremujorin e katërt të vitit 2013, pritet që burimet kryesore të financimit dhe konsumit në ekonominë e vendit të vazhdojnë të rriten. Bizneset në përgjithësi kanë raportuar pritje pozitive për sa i përket aktivitetit të përgjithshëm ekonomik, ndërkohë që punësimi pritet të mbetet pothuajse i njëjtë. Po ashtu, bankat komerciale kanë raportuar se pritet që standardet e kredisë të lehtësohen dhe kërkesa për kredi për ndërmarrjet, veçanërisht për NVM-të të rritet.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> -----	<b>i</b>
<b>Ekonomia globale</b> -----	<b>03</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>04</b>
Sektori Real -----	04
Sistemi Financiar-----	06
Sektori Bankar -----	06
Kompanitë e Sigurimit -----	11
Fondet Pensionale -----	11
Institucionet Mikrofinanciare-----	11
Tregu i Bonove të Thesarit -----	12
Sektori Fiskal-----	12
Sektori i Jashtëm-----	13
<b>GRAFIKËT DHE TABELAT</b> -----	<b>03</b>
Figura 1. Çmimi i naftës “brent crude” -----	03
Figura 2. Çmimet e metaleve -----	03
Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit-----	04
Figura 4. Norma e këmbimit e euros-----	04
Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit e ECB-së -----	04
Figura 6. Vlerësimi i Bizneseve për situatën biznesore dhe pritjet për punësim-----	05
Figura 7. Indeksi i Çmimeve të Konsumit -----	05
Figura 8. Regjistri i bizneseve -----	06
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	06
Figura 10. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave-----	07
Figura 11. Trendi i rritjes së kredive-----	07
Figura 12. Trendi i rritjes së depozitave -----	08
Figura 13. Mesatarja kuartale e normave të interesit -----	09
Figura 14. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ndërmarrjeve -----	09
Figura 15. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë -----	10
Figura 16. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive jo performuese -----	11
Figura 17. Treguesit e profitabilitetit-----	11
Figura 18. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë-----	12

Figura 19. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar-----	13
Figura 20. Remitencat -----	14
Figura 21. Struktura e investimeve te huaja direkte sipas komponentëve -----	14
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	15

## SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( <i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i> )
CHF	Franku Zvicerran ( <i>angl. Swich Franc: CHF</i> )
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit ( <i>angl. Consumer Price Index: CPI</i> )
ECB	Banka Qendrore Evropiane ( <i>angl. European Central Bank: ECB</i> )
EUR	Valuta Euro ( <i>angl. Euro currency</i> )
GBP	Poundi Britanik ( <i>angl. The Pound Sterling</i> )
IHD	Investimet e Huaja Direkte ( <i>angl. Foreign Direct Investments: FDI</i> )
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar ( <i>angl. International Monetary Fund: IMF</i> )
NPL	Kredive Jopërfomuese ( <i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i> )
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete ( <i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i> )
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i> )
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USD	Dollari Amerikan ( <i>angl. United States Dollar</i> )


## Ekonomia Globale

Vendet e zhvilluara vazhduan të karakterizohen me aktivitet të përshpejtuar ekonomik edhe në TM3 2013, ndërsa vendet në zhvillim edhe pse ende janë bartësit kryesor të rritjes ekonomike globale, kanë pasur normë më të ulët të rritjes krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, Eurostat-i ka vlerësuar se në TM3 2013 eurozona ka shënuar rënie ekonomike prej 0.4 përqind krahasuar me TM3 2012. Rrjedhimisht, rritja globale ekonomike për vitin 2013 pritet të jetë 2.9 përqind ndërkohë që në vitin 2012 ishte shënuar rritje prej 3.2 përqind (FMN, WOE 2013).

Rajoni i Evropës Juglindore (EJL) në përgjithësi u karakterizua me rritje ekonomike. Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova shënuan normat më të larta të rritjes, ndërsa, Shqipëria dhe Serbia përkundër se vazhdojnë të kenë norma pozitive të rritjes, janë ballafaquar me ulje të parashikimeve për rritje ekonomike.

**Inflacioni** vlerësohet të ketë shënuar rënie në TM3 2013. Sipas vlerësimeve të Eurostat-it, inflacioni në eurozonë shënoi rënie nga 2.5 përqind sa ishte në TM3 2012 në 1.3 përqind në TM3 2013. Edhe në SHBA u shënuar rënie e shkallës së inflacionit nga 1.7 përqind në TM3 2012 në 1.1 përqind në TM3 2013. Çmimet e naftës (brent crude)<sup>1</sup> në TM3 2013 shënuan rënie për rreth 4.2 përqind krahasuar me TM3 2012. Efekti i çmimeve të naftës është reflektuar në ngushtim të deficitit të llogarive rrjedhëse të shumë vendeve që kryesisht janë vende importuese të naftës.


Figura 1. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg (2013)

Në anën tjetër, rënia e çmimeve të produkteve kryesore vazhdon të reflektojë edhe në çmimet e metaleve që gjatë viteve u karakterizuan me ndryshime të vogla dhe tendencë rënëse.

Figura 2. Çmimet e metaleve, në USD për ton




Burimi: Bloomberg (2013)

Çmimet e ushqimit vazhdojnë të karakterizohen me rënie që konsiderohet të jetë shkaktuar nga çmimet e energjisë dhe naftës. Gjithashtu, edhe oferta relativisht stabile gjatë vitit 2013 ka ndikuar që çmimet e produkteve ushqimore të mos rriten. Rënia vjetore e çmimeve të ushqimit në nivel global gjatë TM3 2013 ishte 4.6 përqind, që më së shumti u nxit nga rënia e çmimeve të drithërave.

<sup>1</sup> 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut i cili është përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.


Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAOUN (2013)

Që nga ndryshimi i fundit në maj të vitit 2013, norma bazë e refinancimit e Bankës Qendrore Evropiane (angl. *European Central Bank: ECB*) mbeti e pandryshuar në nivelin prej 0.5 përqind deri në shtator 2013. ECB gjithashtu ka njoftuar se që nga 13 nëntori 2013, norma bazë e refinancimit do të zvogëlohet edhe më tutje në 0.25 përqind, që njëherësh paraqet nivelin më të ulët historik.

Figura 4. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e refinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2013) dhe ECB (2013)


Arsyet për ndryshimet në normën bazë të interesit konsiderohet të jetë rënia e vazhdueshme e normës së inflacionit në eurozonë; prandaj, nëpërmjet lehtësimit të financimit për banka, përveç stimulimit të

aktivitetit ekonomik, ECB synon të arrijë inflacionin konform nivelit të targetuar prej rreth 2 përqind.

Normat e interesit të kreditimit ndërbankar gjatë TM3 2013 shënuan rënie. Normat 1-mujore nuk patën ndryshime gjatë TM3 2013; ndërsa normat për periudhë 12-mujore u karakterizuan me rënie nga mesatarisht 0.89 sa ishin në TM3 2012 në 0.54 përqind në TM3 2013.

**Norma e këmbimit të euros kundrejt valutave kryesore** ka vazhduar të forcohet në TM3 2013 krahasuar me TM3 2012.

Figura 5. Norma e këmbimit e Euros



Burimi: BQK (2013)

Norma e këmbimit të euros u forcua ndaj funtës britanike me 7.9 përqind, pastaj ndaj dollarit amerikan me 5.8 përqind dhe frankës zvicerane me 2.6 përqind (Figura 5).

## Ekonomia e Kosovës


### Sektori Real

Zhvillimet në treguesit kryesor makroekonomik sygjerojnë se aktiviteti ekonomik në vend ka shënuar përmirësim të lehtë. Rrjedhimisht, pritjet janë se rritja ekonomike në vitin 2013 të jetë më e lartë se ajo e vitit 2012. Për dallim nga vitet paraprake, deri në

shtator 2013, janë shënuar përmirësime në sektorin e jashtëm të ekonomisë. Sektorët tjerë të ekonomisë gjithashtu kanë vazhduar të kenë norma pozitive të rritjes, por efekti i tyre ka mbetur më i limituar.

Zhvillimet në sektorin e biznesit sipas anketës së Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), të paraqitura në formë të indeksit të besueshmërisë së bizneseve (*angl: business confidence index, BCI*)<sup>2</sup>, janë raportuar të jenë më pozitive në krahasim me tremujorët paraprak (Figura 6).

Figura 6. Vlerësimi i bizneseve për situatën biznesore dhe pritjet për punësim, indeks



Burimi: OEK (2013)


Në kontekst të situatës së përgjithshme biznesore, rezultati i anketës tregon se indeksi ka arritur në 61.5 pikë, që paraqet situatë më të favorshme në krahasim me TM2 2013. Në anën tjetër, pritjet janë se punësimi nuk do të rritet në tremujorin e ardhshëm.

**Inflacioni në Kosovë**, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (*angl: Consumer Price Index: CPI*), gjatë TM3 2013 u karakterizua me rënie të dukshme. Norma mesatare vjetore e inflacionit në

TM3 2013 ishte 1.2 përqind krahasuar me normën prej 3.2 përqind në TM3 2012 (Figura 7).

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë vazhdojnë të jenë mjaft të ngjashme me zhvillimet globale pasi që rënia e çmimeve të mallrave kryesore, si nafta, ndikon edhe në koston e prodhimit në Kosovë.

Figura 7. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit, dhe importit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2013)

Kjo konfirmohet deri diku edhe nëpërmjet indeksit të çmimeve të importit (*angl: Import Price Index: IPI*). Të dhënat e CPI-së kanë sjellje mjaft të ngjashme me ato të IPI-së, që në bazë vjetore shënuan rritje prej 0.2 përqind në TM2 2013. Ndërsa, çmimet e prodhimit në TM2 2013 u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.9 përqind, rritje kjo e cila u nxit nga komponenta e linjitet, mineraleve dhe produkteve të industrive tjera nxjerrëse, çmime këto që janë të administruara nga rregullatorët.

Gjatë TM3 2013, në Kosovë u regjistruan 2011 biznese të reja ndërsa, ndërsa u mbyllën 342 biznese. Gjatë periudhës janar – shtator 2013 u regjistruan 7,616 biznese të reja apo 285 biznese më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sidoqoftë, edhe mbyllja e bizneseve kishte rritje në periudhën


<sup>2</sup>Kalkulimi i BCI-së është si në vazhdim:

$$BCI = (P * 1) + (A * 0.5) + (N * 0)$$

ku P paraqet përgjigjet pozitive, A paraqet përgjigjet neutrale ndërsa N paraqet përgjigjet negative. Në këtë kontekst, kur rezultati i indeksit merr vlerën 50 situata e përgjithshme është e pandryshuar. Kur vlera e indeksit është më e ulët se 50 situata konsiderohet negative, ndërsa kur indeksi tejkalon vlerën 50 situata konsiderohet pozitive.

janar – shtator 2013 pasi që u mbyllën rreth 1,104 biznese apo 357 biznese më shumë se sa në periudhën janar – shtator 2012.


Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2013)

Trendet sa i përket strukturës së ndërmarrjeve kanë vazhduar të jenë të ngjashme me periudhat paraprake, ku dominon sektori i tregtisë me 29.5 përqind, pasuar nga hotelet dhe restorantet me 11.9 përqind, ndërtimtaria me 10.0 përqind, patundshmëritë me 8.9 përqind, etj. (Figura 9).

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2013)

## Sistemi Financiar

### Sektori Bankar


Sektori bankar i Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë TM3 2013. Gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.9 miliard euro në shtator 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind. Sidoqoftë, rritja e aseteve të sektorit bankar nuk është shoqëruar me një rritje të theksuar të rrjedhës së fondeve drejtë ekonomisë, duke qenë se rritjen më të madhe në kuadër të aseteve e ka shënuar kategoria e bilancit në BQK. Bilanci i bankave komerciale në BQK arriti vlerën prej 323.8 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 34.7%.

Investimet në letra me vlerë, një pjesë e konsiderueshme e të cilave përbëhet nga investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës, në shtator 2013 arritën vlerën prej 276.0 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 8.1 përqind.

Për sa i përket kreditimit të ekonomisë nga sektori bankar, edhe gjatë tremujorit të tretë aktiviteti kredidhënës ka vazhduar të rritet, por me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin e kaluar. Në shtator 2013, gjithsej kreditë shënuan vlerën prej 1.8 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.2 përqind e cila është më e ulët krahasuar me rritjen prej 2.8% në TM3 2012 (Figura 10). Pjesa më e madhe e kredive të sektorit bankar vazhdon të përfaqësohet nga kreditë e lëshuara për ndërmarrjet të cilat përbëjnë 68 përqind të gjithsej kredive. Vlera e e kredive për ndërmarrjet në shtator 2013 shënoi rritje vjetore prej 3.1 përqind (4.2 përqind në shtator 2012). Kreditë për ekonomitë familjare kanë një pjesëmarrje prej 31 përqind në gjithsej kreditë, dhe vlera e tyre shënoi rritje vjetore

prej 2.6 përqind në shtator 2013 (8.6 përqind në shtator 2012). Kjo tregon se ngadalësimi i kredithënies që në vitet paraprake kishte prekur më tepër ndërmarrjet, gjatë vitit 2013 ka filluar të vërehet në masë më të theksuar edhe te kreditë e ekonomive familjare.

Figura 10. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


Krahasuar me TM2 2013, gjithsej kreditë shënuan rënie prej 1.5 përqind, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të kredive për ndërmarrjet private, dhe në masë më të vogël edhe zvogëlimit të kredive të ekonomive familjare. Megjithatë, në figurën 11 vërehet ekzistenca e faktorit sezonal (sezonalitetit) në trendin e rritjes së kredive, ku shihet që në vazhdimësi tremujori i tretë i vitit është karakterizuar me nivel më të ulët të kreditimit edhe gjatë viteve të kaluara.

Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar tregojnë se gjatë TM 2013 krahasuar me TM2 2013 bankat kanë shtrënguar standardet dhe kriteret e aplikuar për kreditimin e ndërmarrjeve në përgjithësi, me theks të veçantë për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët kryesorë që bankat deklaruan të kenë ndikuar në shtrëngimin e standardeve kreditore për ndërmarrjet në përgjithësi ishin pritjet e tyre në lidhje me aktivitetin ekonomik në vend, problemet specifike të sektorit ku

zhvillojnë aktivitetin ndërmarrjet dhe rreziku nga kërkesa për kolateral. Bankat realizuan politikat e tyre shtrënguese kreditore për ndërmarrjet kryesisht përmes rritjes së normave të interesit për kreditë me rrezikshmëri më të lartë, zvogëlimit të shumës së kredisë, kërkesës më të lartë për kolateral dhe shkurtimit të afatit të maturimit.

Sa i përket standardeve të aplikuar për kreditimin e ekonomive familjare, bankat kanë deklaruar lehtësim deri në një masë gjatë kësaj periudhe. Sipas raportimit të bankave, lehtësimi i standardeve për kreditimin e ekonomive familjare kryesisht erdhi si rezultat i presioneve konkurruese nga bankat tjera.

Figura 11. Trendi i rritjes së kredive, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Bazuar në rezultatet e anketës, gjatë TM3 2013 kërkesa për kredi nga ndërmarrjet në përgjithësi ka shënuar rënie deri në një masë, si për ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi për blerje të shtëpive, përderisa kërkesa për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera ishte më e ulët krahasuar me TM2 2013.



Në kontekst të kërkesës për kredi, në vitet e fundit është vërejtur një zhvendosje e bizneseve nga përdorimi i kredive afatshkurtëra në drejtim të përdorimit të mbitërheqjeve si formë e financimit afatshkurtër. Kjo zhvendosje mund të ketë qenë rezultat i shtrëngimit të kritereve nga bankat për kreditim, por edhe për shkak të kostos më të ulët të financimit përmes produktit të mbitërheqjes.

Sa i përket pritjeve për TM4 2013, standardet e kreditimit pritet të lehtësohen deri në një masë (për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare). Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet, veçanërisht nga NVM-të, pritet të rritet gjatë tre muajve të ardhshëm. Bankat presin rritje të kërkesës edhe për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera, ndërsa kërkesa për kredi për blerje të shtëpive pritet që deri në një masë të pësojë rënie.


Struktura e kredive të ndërmarrjeve vazhdon të dominohet nga kreditë për tregti, që kanë një pjesëmarrje prej 51.7 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Norma vjetore e rritjes së kredive për ndërmarrjet tregtare ishte 1.6 përqind në shtator 2013, krahasuar me rritjen prej 2.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Ngadalësimi i kreditimit të sektorit bankar gjatë TM3 2013 ndikoi më shumë mbi kreditë për sektorët e prodhimit dhe ndërtimit. Kreditë për sektorin e prodhimit shënuan rënie vjetore prej 3.1 përqind, përderisa kreditë për ndërtimin shënuan rënie prej 2.4 përqind. Në anën tjetër, kreditimi i sektorit të bujqësisë u karakterizua me zhvillime pozitive në këtë periudhë, duke shënuar rritje vjetore prej 30.9 përqind në shtator 2013. Kreditë për sektorin e bujqësisë në shtator 2013 arritën vlerën

prej 55.4 milionë euro. Një rritje e konsiderueshme u regjistrua edhe te kreditë për shërbime tjera financiare (patundshmëri, qera, etj.) të cilat arritën vlerën prej 67.8 milion euro në shtator 2013, duke shënuar një rritje vjetore prej 31.5 përqind.

Në shtator 2013, gjithsej depozitat në sistemin bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.3 përqind (5.2 përqind në shtator 2012), duke arritur kështu vlerën prej 2.3 miliard euro. Kontribuues kryesor në rritjen e gjithsej depozitave të sistemit bankar vazhduan të jenë depozitat e ekonomive familjare. Sa i përket depozitave të ndërmarrjeve, depozitat e ndërmarrjeve private dhe depozitat e korporatave tjera publike shënuan rritje vjetore prej 8 përkatësisht 10.1 përqind në TM3 2013. Përfundimisht bëjnë depozitat e korporatave tjera financiare që u karakterizuan me rënie në shtator 2013, kryesisht si pasojë e performancës negative që kishin kompanitë e sigurimit në periudhat e fundit si dhe tërheqjes së një pjese të depozitave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga sektori bankar gjatë tremujorit të dytë të vitit.

Figura 12. Trendi i rritjes së depozitave, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Krahasuar me TM2 2013, kur u shënuar rënie kuartale prej 3.0 përqind në depozita, gjatë TM3 2013


norma kuartale e rritjes së depozitave ishte 6.5 përqind. Rritja e depozitave gjatë tremujorit të tretë, mes tjerash, poashtu reflekton efektin e sezonalitetit.

Bazuar në figurën 12, vërehet se edhe në vitet paraprake tremujori i dytë është karakterizuar me nivel më të ulët të depozitave, ndërsa tremujori i tretë është karakterizuar me rikuperim të trendit të depozitave në sektorin bankar.

Sektorët kryesor që kontribuuan në rritjen më të shpejtë të depozitave në TM3 2013 krahasuar me TM2 2013 ishin rritja e depozitave të ndërmarrjeve private dhe depozitave të ekonomive familjare.

Rënia e vazhdueshme e normave të interesit në kreditë bankare është reflektuar në ngushtimin e dallimit ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita. Në TM3 2013, ky dallim u zvogëluar në 8.8 përqind, krahasuar me 9.7 përqind në TM3 2012, përderisa mbeti në nivel të ngjashëm me TM2 2012.

Figura 13. Mesatarja kuartale e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Në TM3 2013, norma efektive e interesit në kredi u zvogëluar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, norma mesatare e interesit në kredi ishte 12.3

përqind, krahasuar me normën mesatare prej 13.4 përqind në TM3 2012 (Figura 13).

Krahasuar me TM2 2013, vërehet se normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, si për kreditë investive ashtu edhe për kreditë tjera biznesore, kanë shënuar rritje të lehtë në TM3 2013 (Figura 14).

Figura 14. Normat mesatare kuartale të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Kjo rritje e lehtë e normave të interesit ishte nxitur nga rritja e interesit për kreditë afatgjata (mbi pesë vite), përderisa me rënie u karakterizuan normat e interesit me maturitet mbi një deri në pesë vite. Sa i përket normave të interesit për kreditë për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese në TM3 2013 ishte 12.4 përqind krahasuar me 12.0 përqind në TM2 2013, përderisa normat mesatare të interesit për kreditë për blerje të shtëpive ishin më të ulëta.

Norma mesatare e interesit në depozita ishte më e ulët në TM3 2013 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në TM3 2013 norma mesatare e interesit në depozita u zvogëluar në 3.5 përqind, nga 3.7 përqind sa ishte TM3 2012, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të normave mesatare të interesit si në

depozitat e ndërmarrjeve ashtu edhe në depozitat e ekonomive familjare. Krahasuar me TM2 2013, mesatarja e normës së interesit në depozita ruajti nivel të ngjashëm.

Sektori bankar u karakterizua me performancë pozitive edhe në TM3 2013, ku fitimi neto i sektorit arriti vlerën prej 22.4 milionë euro, që tregon për një rritje prej 5.2 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përderisa të hyrat e sektorit bankar kanë shënuar rritje të lehtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjithsej shpenzimet kanë pësuar rënie dhe kjo kryesisht për shkak të shpenzimeve më të ulëta në kategorinë e shpenzimeve për provizione dhe shpenzimeve tjera jo nga interesi.


Deri në shtator 2013, norma e Kthimit në Mesataren e Aseteve (ROAA)<sup>3</sup> u përmirësua në 1.0 përqind, nga 0.7 përqind sa ishte në dhjetor 2012. Edhe norma e Kthimit në Mesataren e Kapitalit (ROAE) në shtator 2013 u përmirësua në 10.8 përqind, nga 7.1 përqind sa ishte në dhjetor 2012 (Figura 17).

Zvogëlimi i shpenzimeve të sektorit bankar është reflektuar edhe në raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar. Në shtator 2013, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave ishte 87.2 përqind, krahasuar me nivelin prej 88.8 përqind sa ishte në shtator 2012. Megjithatë, kryesisht si pasojë e rënies më të madhe të shpenzimeve në qershor 2013 krahasuar me shtatorin 2013, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit bankar ishte më i lartë në shtator të këtij viti krahasuar me qershorin 2013 kur ky raport qëndroi në 86.7 përqind.

Pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë ka arritur në 8.5 përqind në shtator 2013, nga 7.8 përqind në qershor 2013 dhe 7.5 përqind në dhjetor 2012 (Figura 15).

Kjo rritje e pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej kreditë kryesisht i atribuohet normës më të

Figura 15. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë




Burimi: BQK (2013)

ulët të rritjes së gjithsej kredive gjatë kësaj periudhe, por se vërehet një rritje me e theksuar edhe në vlerën e NPL-ve në tremujorin e tretë (Figura 16). Sektorët që kontribuuan në rritjen e kredive joperformuese gjatë kësaj periudhe ishin kryesisht tregtia dhe industria prodhuese.

Kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbjet e mundshme nga kreditë (Figura 17). Në shtator 2013, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë është rritur në 113.2 përqind, krahasuar me 112.6 përqind në dhjetor 2012. Sektori bankar vazhdoi të ketë nivel të kënaqshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit edhe në TM3 2013. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) në shtator 2013 arriti në 16.4 përqind nga 14.2 përqind sa ishte në dhjetor 2012.

<sup>3</sup> Treguesit ROAA dhe ROAE janë të aktualizuar.


Figura 16. Rritja vjetore e gjithsej kredive dhe kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Përforcimi i kapitalizimit të sektorit bankar krahasuar me fundin e vitit të kaluar i atribuohet kryesisht përmirësimit të performancës së sektorit bankar në sajë të rritjes së profitit si dhe shtimit të kapitalit nga aksionarët si rezultat i kërkesave të reja të rregullatorit.

Figura 17. Treguesit e profitabilitetit



\*Profiti i anualizuar i tremujorit të tretë  
Burimi: BQK (2013)

Gjithashtu, sektori bankar vijoi të mbajë nivel të kënaqshëm të likuiditetit. Në TM3 2013, raporti i kredive ndaj depozitave u zvogëlua në 76.7 përqind, nga 77.4 përqind në dhjetor 2012. Në të njëjtën periudhë, raporti i aseteve të gjëra likuide (*ang: broad liquid assets*) ndaj gjithsej aseteve u zvogëlua lehtë duke rënë në 32.1 përqind, nga 32.6 përqind në dhjetor 2012.

### Kompanitë e sigurimit

Deri në shtator 2013, gjithsej asetet e industrisë së sigurimeve në Kosovë arritën në 131.6 milion euro, një rritje vjetore prej 0.9 përqind. Vlera e primeve të kontraktuara gjatë kësaj periudhe arriti në 49.9 milion euro që, krahasuar me shtatorin e vitit 2012, paraqet një rritje vjetore prej 8.6 përqind. Me rritje më të lartë vjetore prej 11.3 përqind u karakterizuan dëmet e ndodhura, që deri në shtator 2013 arritën vlerën prej 19.9 milion euro. Tregu i sigurimeve u karakterizua me humbje në vlerë prej 96,326 euro deri në shtator 2013, kryesisht si pasojë e rritjes vjetore të nivelit të gjithsej shpenzimeve tjera dhe dëmeve të ndodhura gjatë kësaj periudhe.

### Fondet pensionale

Gjithsej vlera e mjeteve nën menaxhim të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në shtator 2013 arriti në 854 milion euro. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës realizoi kthim pozitiv nga investimet në vlerë prej 41.5 milion euro deri në shtator 2013. Në të njëjtën kohë, edhe vlera e çmimit të aksionit arriti në 1.17 euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.4 përqind.

### Institucionet mikrofinanciare

Në shtator 2013, asetet e institucioneve financiare (IMF) kishin një vlerë prej 111.8 milion euro, një zvogëlim krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 7.5 përqind. Zvogëlimi i aseteve reflekton zvogëlimin e mëtejshëm të kreditimit nga IMF-të. Në shtator 2013, gjithsej kreditë e lëshuara nga IMF-të arritën vlerën prej 72.5 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 8.6 përqind.

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga IMF-të shënoi rritje të mëtutjeshme duke arritur në 23.2 përqind në TM3 2013, krahasuar me 23 përqind në TM2 2012. Megjithatë, ky sektor vazhdoi të operojë me humbje, por e cila ishte më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në shtator 2013, sektori i institucioneve mikrofinanciare shënoi humbje prej 1.3 milion euro krahasuar me humbjen prej 3.9 milionë euro në shtator 2012. Zvogëlimi i humbjes rezultoi nga zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve për 17.2 përqind, përderisa të hyra shënuan një rënie vjetore prej 4.6 përqind.

### Tregu i Bonove të Thesarit

Deri në shtator 2013, konform kalendarit të publikuar, u shpallën 16 ankande për letra me vlerë, nga të cilat 9 për periudhë maturimi 91 ditë, 6 për periudhë maturimi 182 ditë dhe, për herë të parë, një për afat maturimi 364 ditë.


Siç edhe është paraqitur në figurën 18, ofertimi gjatë vitit 2013, ashtu sikurse gjatë vitit 2012, ka qenë mbi 2 herë më i lartë se sa shuma e kërkuar, ndërsa norma vjetore e interesit për shumat 10 milionë euro ka vazhduar të jetë rreth 0.5 përqind.

Ndërsa, në ankandet për shumat 20 milionë euro, me afat maturimi 182 ditë, ofertimi ishte 1.8 herë më i lartë dhe norma mesatare vjetore e interesit ishte 1.42 përqind. Normë më e lartë e interesit u regjistrua në ankandin për 20 milion euro me afat maturimi prej 364 ditë, e cila arriti në 2.26 përqind.

### Sektori Fiskal

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore deri në fund të shtatorit 2013 arriti në 1.01 miliardë euro që

Figura 18. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumat e ofertuara për 91 ditë.  
Burimi: BQK (2013)

paraqet një ngritje prej 1.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, të hyrat buxhetore shënuan rënie vjetore prej 6.2 përqind duke shënust vlerën prej 1.06 miliardë euro.

Shpenzimet qeveritare për investime kapitale deri në shtator të vitit 2013 shënuan rënie vjetore prej 5.7 përqind. Shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore në kuadër të shpenzimeve buxhetore, me pjesëmarrje prej 34.7 përqind të gjithsej shpenzimeve (348.4 milionë euro). Në anën tjetër, deri në muajin shtator, shpenzimet qeveritare për konsum të mallrave dhe shërbimeve kanë shënuar rritje vjetore prej 1.5 përqind, duke arritur në 115.0 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje si dhe shpenzimet qeveritare për subvencione dhe transfere kanë shënuar rritje prej 2.4 përkatësisht 20.7 përqind duke arritur në 277.5 përkatësisht 227.3 milionë euro.

Rënia e të hyrave buxhetore prej 6.2 përqind i adresohet kryesisht rënies së të hyrave vetanake të komunave dhe të nivelit qendror prej 8.0 përqind dhe nivelit më të ulët të pranimeve nga emetimi i letrave me vlerë prej 18.6 përqind. Në anën tjetër, të hyrat neto të mbledhura nga ATK-ja shënuan rritje prej 12.1 përqind duke arritur nivelin neto prej 202.9

milionë euro. Përkundër rënies së importit, të hyrat e mbledhura në kufi arritën vlerën neto prej 608.2 milionë euro duke shënuar një ngritje prej 1.3 përqind.

### **Sektori i Jashtëm**


Bilanci i pagesave të Kosovës vazhdon të karakterizohet me deficit të llogarisë rrjedhëse, i cili në TM2 2013 ishte 147.6 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.2 përqind. Ky nivel i deficitit të llogarisë rrjedhëse shkaktohet kryesisht nga deficitit tregtar i cili deri në shtator 2013 shënoi zvogëlim prej 4.6 përqind duke arritur në 1.6 miliardë euro.

Deri në shtator 2013, gjithsej eksportet kanë shënuar rritje vjetore prej 9.4 përqind dhe kanë arritur në 224.0 milionë euro, ndërsa importet kanë shënuar rënie prej 3.0 përqind dhe kanë arritur në 1.8 miliardë euro. Rritja e eksporteve dhe rënia e importeve ka bërë që deficitit tregtar të shënojë rënie vjetore prej 4.6 përqind dhe të përmirësojë shkallën e mbulueshmërisë së importeve me eksporte nga 11.0 përqind sa ishte deri në shtator të vitit të kaluar në 12.4 përqind deri në shtator të vitit 2013 (Figura 19).

Komponentët tjerë të llogarisë rrjedhëse kanë bilance pozitive dhe rrjedhimisht ndikojnë në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rënia e importit të shërbimeve prej 8.8 përqind, përkundër rënies së eksportit të shërbimeve prej 0.8 përqind, ka ndikuar që bilanci i llogarisë së shërbimeve të shënojë rritje prej 7.0 përqind dhe të arrijë në 137.9 milionë euro në qershor të vitit 2013.

Në anën tjetër, bilancet e llogarisë së të ardhurave dhe transfereve rrjedhëse, përkundër ndikimit pozitiv

Figura 19. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative




Burimi: ASK (2013)

në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, shënuar rënie për 8.4 përkatësisht 1.1 përqind. Kompensimi i punëtorëve, kryesisht atyre që punojnë në Irak dhe Afganistan, si njëri ndër komponentët kryesor të pranimeve në kuadër të të ardhurave, ka shënuar një rënie të lehtë prej 0.7 përqind duke arritur vlerën prej 110.0 milionë euro. Në anën tjetër, kategoria e të ardhurave nga investimet që përbëhet kryesisht nga shpërndarja e dividendës nga kompanitë e huaja që kanë investuar në Kosovë, është me bilanc të vazhdueshëm negativ. Deri në qershor të vitit 2013, kjo kategori kishte bilanc negativ prej 36.0 milionë euro e cila krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 13.1 përqind.

Remitencat, të cilat paraqesin komponentin kryesor në kuadër të transfereve rrjedhëse, në fund të qershorit 2013 arritën vlerën prej 272.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 4.2 përqind. Kjo rritje e remitencave paraqet një kontribut të rëndësishëm për ngushtimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse si dhe rritjes së konsumit në vend (Figura 20).

Deri në qershor 2013, vlera e IHD-ve arriti në 143.4 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 66.4


Figura 20. Remitenecat, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

përçind. Të gjitha komponentët e IHD-ve shënuan rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 21).

Figura 21. Struktur e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Vendet nga të cilat ka rrjedhë pjesa më e madhe e IHD-ve gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 ishin Turqia me 36.1 përçind, pasuar nga Britania e Madhe dhe Zvicra me 18.1 përkatësisht 14.3 përçind. Sa i përket sektorëve, edhe gjatë kësaj periudhe, IHD-të kanë qenë të koncentruara në sektorin e patundshmërive (32.4 përçind), ndërtimtarisë (15.7 përçind), transportit dhe telekomunikacionit (12.7 përçind).

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2012	Shtator 2013
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	2.1%	2.2%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	4.1%	0.2%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat (në milionë euro)	1,127.1	1,056.8
Shpenzimet (në milionë euro)	992.1	1,005.5
Bilanci, si përqindje e PBB-së	-	-
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	3,724.3	4,045.7
prej të cilave: Bankat	2,765.3	2,935.4
Kredi	1,758.7	1,798.0
Depozita	2,206.5	2,344.7
Norma e interesit në kredi	13.8	12.2
Norma e interesit në depozita	3.7	3.4
Hendeku i normës së interesit	10.1	8.8
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/	<b>Qershor 2012</b>	<b>Qershor 2013</b>
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-141.7	-147.6
prej të cilave: importi i mallrave	-1,062.1	-1,075.4
prej të cilave: remitencat	261.5	272.4
Llogaria financiare	89.6	143.1
Investimet e huaj direkte në Kosovë	86.2	143.4
Investimet portfolio, net	-43.8	-136.2
Investimet tjera, net	79.8	149.8
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	173.1	281.7
Asetet	3,352.7	3,848.7
Detyrimet	3,179.6	3,567.0
Borgji i jashtëm, gjithsej	1,385.0	1,514.3
Borgji i jashtëm privat	1,064.1	1,119.5
Borgji i jashtëm publik	320.9	394.8

Burimi:

1/ ASK (2013).

2/ MF (2013).

3/ BQK (2013).

